



Originali: **anglisht**

Nr.: **ICC-02/05-01/09**

Data: 21 July 2010

DHOMA PARA-GJYQËSORE I

Para: Gjyqtare Sylvia Steiner, Kryetare e Trupit Gjykses
Gjyqtare Sanji Mmasenono Monageng
Gjyqtarit Cuno Tarfusser

**SITUATA NË DARFUR, SUDAN
NË LËNDËN**

**PROKURORI kundër OMAR HASSAN AHMAD AL BASHIR-it ("OMAR AL
BASHIR")**

Dokument Publik

**KËRKESE PLOTËSUESE PËR TË GJITHA SHITETET PALË TË STATUTIT TË
ROMËS PËR ARRESTIMIN DHE DORËZIMIN E OMAR HASSAN AHMAD AL
BASHIR-it**

Burimi: Sekretari i Gjyqit

Të njoftohen me dokumentin në përputhje me rregulloren 31 të *Rregulloreve të Gjykatës*:

Zyra e Prokurorit

Z. Luis Moreno-Ocampo, Prokuror
Z. Essa Faal, Avokat i Lartë Gjyqësor

Avokati i Mbrojtjes

Përfaqësuesit Ligjorë të Viktimave

Z. Nicholas Kaufman
Z-(sha)a Wanda M. Akin
Z. Raymond M. Brown

Përfaqësuesit Ligjorë të Paditësve

Viktimat e Papërfaqësuar

**Paditësit e Papërfaqësuar për
Pjesëmarrje/Zhdëmtim**

Zyra e Avokatit Publik për Viktimat

Z-(ush)a Paolina Massida

Zyra e Avokatit Publik për Mbrojtjen

Z. Xavier-Jean Keïta

Përfaqësuesit e Shteteve

Miqtë e Gjykatës

SEKRETARIA

Sekretarja e Gjykatës

Znj. Silvana Arbia

Ndihmës Sekretari i Gjykatës

Z. Didier Preira

Sekretarja e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Gjykata”);

DUKE MARRË SHËNIM rekomandimin për situatën në Darfur, Sudan, për Prokurorin e Gjykatës nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Rezolutën e vet 1593 31 maj 2005;¹

DUKE MARRË SHËNIM *Decision on the Prosecution’s Application for a Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir* lëshuar më 4 mars 2009 nga Dhoma Paragjyqësore I (“Vendimi”);²

DUKE MARRË SHËNIM *Warrant of Arrest against Omar Hassan Ahmad Al Bashir* lëshuar më 4 mars 2009 nga Dhoma Paragjyqësore I (“Dhoma”) sipas nenit 58 të Statutit të Romës;³

DUKE MARRË SHËNIM *Second Decision on the Prosecutions Application for a Warrant of Arrest* të datës 12 korrik 2010;⁴

DUKE MARRË SHËNIM *Second Warrant of Arrest for Omar Hassan Ahmad Al Bashir* të datës 12 korrik 2010;⁵

DUKE MARRË SHËNIM nenet 57 deri 60, 67, 87, 89, 91 dhe 97 të Statutit të Romës (“Statuti”), rregullat 117, 176, 184, 187 dhe 196 të Rregullave të Procedurës dhe Evidencës (“Rregullat”) dhe rregulloret 31 dhe 111 të Rregulloreve të Gjykatës (“Rregulloret”);

DUKE MARRË PARASYSH se neni 89(1) i Statutit parasheh se Gjykata mund të paraqesë kërkesë për arrestim dhe dorëzim të një individi te cilito Shtet në territorin e të cilit mund të gjendet ai individ;

¹ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 1593, S/RES/1593 (2005), miratuar më 31 mars 2005.

² ICC-02/05-01/09-3.

³ ICC-02/05-01/09-1.

⁴ ICC-02/05-01/09-94.

⁵ ICC-02/05-01/09-95.

DUKE MARRË PARASYSH se urdhër arresti i dytë për Omar Al Bashir-in “nuk e revokon apo zëvendëson në çfarëdo pikëpamjeje urdhër arrestin e mëparshëm lëshuar më 4 mars 2009, i cili mbetet kështu në fuqi”;⁶

DUKE MARRË PARASYSH se Dhoma ka kërkuar nga Sekretaria të:

- (i) përgatisë një kërkesë plotësuese për bashkëpunim në kërkim të arrestimit dhe dorëzimit të Omar Al Bashir-it për pikat që përmbajnë që të dy urdhër arrestet, i pari dhe i dyti, dhe që përmban informacionin dhe dokumentet që kërkohen me nenin 89(1) dhe 91 të Statutit, dhe sipas rregullës 187 të Rregullave; dhe (ii) t’ua paraqesë një kërkesë të tillë autoriteteve kompetente sudaneze në pajtim me rregullën 176(2) të Rregullave, të gjitha Shteteve Palë të Statutit dhe të gjitha anëtareve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që nuk janë Shtete Palë të Statutit;⁷

KËRKON që individi në vijim të arrestohet dhe të dorëzohet në pajtim me dy urdhër arrestet:

- Mbiemri: Al Bashir;
- Emri/emrat: Omar Hassan Ahmad;
- Emri dhe mbiemri shkruhen po ashtu: Omar al-Bashir; Omer Hassan Ahmed El Bashire, Omar al-Bashir, Omar al-Beshir, Omer Albasheer, Omar Elbashir dhe Omar Hassan Ahmad el-Béshir;
- Data e lindjes: 1 janar 1944;
- Vendi i lindjes: Hoshe Bannaga, Shendi Governorate, Republika e Sudanit;

⁶ ICC-02/05-01/09-94, faqe 28.

⁷ Idem.

- Kombësia: sudaneze;
- Profesioni: President i Republikës së Sudanit;
- Akuzat: ai pretendohet të ketë kryer:
 - i) krime lufte sipas nenit 8 të Statutit;
 - ii) krime kundër njerëzimit sipas nenit 7 të Statutit dhe
 - iii) gjenocid sipas nenit 6 të Statutit.

Në rast të arrestimit dhe dorëzimit:

KËRKON që të ndërmerren të gjitha masat përkatëse për sigurinë e Omar Hassan Ahmad Al Bashir-it deri në dorëzimin e tij përfundimtar te Sekretari i Gjykatës;

KËRKON që Gjykatata të njoftohet për çfarëdo aplikacioni të bërë nga Omar Hassan Ahmad Al Bashir-i te ndonjë gjykatë nacionale sipas nenit 59(3) apo 89(3) të Statutit;

KËRKON në përputhje me nenin 87(4) të Statutit të Romës, që çfarëdo informacioni që vihet në disponim lidhur me këtë kërkesë të jepet dhe të përdorohet në një mënyrë që të mbrojë sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike të çfarëdo viktime, dëshmitari të mundshëm dhe të familjeve të tyre;

KËRKON që Gjykata të njoftohet, në përputhje me nenin 91(2)(c) të Statutit të Romës, për çfarëdo dokumentesh, deklaratash apo infomacioni, tjetër nga urdhër arresti, që mund të jenë të domosdoshme për të plotësuar kërkesat për procesin e dorëzimit;

KËRKON që Gjykata të njoftohet, në përputhje me nenin 97 të Statutit, për çfarëdo problemi që mund të pengojë apo ndalojë ekzekutimin e kësaj kërke;

KËRKON që Gjykata të njoftohet, në përputhje me nenin 89(4) të Statutit të Romës, për çfarëdo problemi që mund të vonojë ekzekutimin e kësaj kërkesë;

KËRKON të informohet Sekretari i Gjykatës menjëherë, në përputhje me nenin 184 të Rregullave, kur është i disponueshëm për dorëzim Omar Hassan Ahmad Al Bashir-i;

KËRKON që Omar Hassan Ahmad Al Bashir-i t'i dorëzohet Gjykatës sa më parë që të jetë e mundshme, kur Omar Hassan Ahmad Al Bashir-i të jetë i disponueshëm për dorëzim;

PËRKUJTON obligimin për t'iu përmbajtur procedurës që parashihet në nenin 59 të Statutit dhe rregullës 117 të Rregullave;

BASHLKËNGJET me këtë kërkesë, në pajtim me nenet 87 dhe 91 të Statutit, rregullën 187 të Rregullave, këto dokumente:

- i) një kopje të *Warrant of Arrest for Omar Hassan Ahmad Al Bashir* lëshuar më 4 mars 2009 (Aneksi 1);
- ii) një kopje të *Second Warrant of Arrest for Omar Hassan Ahmad Al Bashir* lëshuar më 12 korrik 2010 (Aneksi 2);
- iii) një kopje të dispozitave relevante të Statutit dhe të Rregullave në një gjuhë të cilën Omar Hassan Ahmad Al Bashir-i e kupton dhe e flet (Aneksi 3).

/nënshkrimi/

**Marc Dubuisson, Drejtor i Divizionit të Shërbimeve të Gjykatës
në emër të Silvana Arbia, Sekretare e Gjykatës**

Datuar më 21 korrik 2010

Në Hagë, Holandë